

TIMOR

PROJEKTI: BASHKË PËR
MË SHUMË MUNDËSI
DHE MBËSHTETJE

Ky publikim u hartua me
ndihmën e Bashkimit Evropian



Projekti është implementuar



LOZA FOUNDATION

Broshura u përgatit në përputhje me udhëzimet Evropiane për lexim të lehtë, në mënyrë që të jetë e aksesshme dhe e lehtë për lexim dhe për ta kuptuar personat me aftësi të kufizuara intelektuale dhe të gjithë njerëzit e tjera



KY PUBLIKIM U HARTUA ME NDIHMËN E BASHKIMIT EVROPIAN.

Bashkimi Evropian (shkurtesa, BE) është grup prej 28 vendeve.

Këto vende i quajmë “vende-anëtare”.

Ato u bashkuan që politikisht dhe ekonomikisht të janë më të fuqishme.

BE miraton ligje të cilët janë të rëndësishëm për personat me aftësi të kufizuara.

Për shembull, u miratua ligji me të cilin personave me aftësi të kufizuara u ofrohen më shumë të drejta kur udhëtojnë.

BE u akordon mjete monetare edhe vendeve të veta anëtare.

Një pjesë e këtyre mjeteve monetare përdoren për personat me aftësi të kufizuara.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e:

1. Qendrës për promovimin e praktikave të qëndrueshme bujqësore (CeProSARD),
2. Shoqatës së edukatorëve dhe rehabilituesve profesionistë të Republikës së Maqedonisë së Veriut (ASERNM),
3. Institutit special (IS) Demir Kapi
4. Komunës së Demir Kapisëdhe
5. Fondacionit Loza Suedi


dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian




QËLLIMI GLOBAL I PROJEKSTIT “TIMOR” ËSHTË:

SHPËRNGULJA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA TË CILËT JETOJNË NË INSTITUCIONE

- INSTITUCIONET JANË VENDE NË TË CILAT JETOJNË PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA INTELEKTUALE, ME PERSONA TË TJERË ME AFTËSI TË KUFIZUARA INTELEKTUALE.
- ATA JETOJNË TË NDARË NGA NJERËZIT E TJERË.
- KJO ËSHTË AJO TË CILËN E QUAJMË “SEGREGIM”.



- **NDONJËHERË NJË GJË E KËTILLË NDODHË KUNDËR VULLNETIT TË TYRE.**
- NJERËZIT TË CILËT JETOJNË NË INSTITUCIONE DUHET T’I NDJEKIN RREGULLAT E INSTITUCIONIT DHE ATA VET NUK MUND TË MARRIN VENDIME.



PËRMES PROJEKTIT “TIMOR” DO T’U NDIHMOJMË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA:

- TË DALIN NGA INSTITUCIONET
- TË JETOJNË NË MËNYRË TË PAVARUR BRENDÀ BASHKËSISË
- TË KENË MBËSHTETJE QË TA BËJNË ATË QË E DËSHIROJNË.

PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA MES TJERASH DO TË KENË MUNDËSI:

- TË ZGJEDHIN ME KË DHE KU DO TË JETOJNË
- TË VENDOSIN SE SI DËSHIROJNË TA KALOJNË KOHËN E TYRE
- TË KENË PËRVOJA TË NJËJTA SI EDHE TË GJITHË NJERËZIT E TJERË
- TË KENË MBËSHTETJE KUR KANË NEVOJË PËR NDIHMË PËR KRYERJEN E PUNËVE TË NDRYSHME DHE KOMPLEKSE.



QËLLIME SPECIFIKE TË PROJEKTIT



QS 1: Të krijojen kushte për deinstitucionalizim

- Deinstitucionalizimi u ndihmon njerëzve të shpërngulen nga institucionet. Që të filloj procesi i deinstitucionalizimit duhet:

- o Të përgatiten kushte për njerëzit të cilët jetojnë nëpër institacione dhe tu ofrohet ndihmë në mënyrë që të jetojnë të pavarur brenda bashkësisë.

QS2: Të bëhet shpërngulja e personave me aftësi të kufizuara nga institucionet rezidenciale në njësi me jetesë të mbështetur

- o Kur do të përgatiten objektet e strehimit dhe personat që do të ofrojnë kujdes dhe ndihmë njerëzve të cilët kanë jetuar në institacione marrin ndihmë, atëherë do të filloj shpërngulja e personave me aftësi të kufizuara.

Qs3: Të zhvillohen dhe implementohen shërbime inovative sociale për përfshirjen aktive në bashkësi të personave me aftësi të kufizuara

- Nëse keni aftësi të kufizuara intelektuale, kjo nënkupton se më vështirë i kuptioni disa informacione dhe më vështirë përvetësoni aftësi të reja, në krahasim me njerëzit e tjera.

- o Kjo disa segmente të jetës i bën më të vështira.
- o Njerëzit me aftësi të kufizuara intelektuale shpeshherë kanë nevojë për mbështetje gjatë nxënies ose punës.
- o Ekzistojnë punë të cilat mund ta bëjnë jetën më të lehtë për personat me aftësi të kufizuara intelektuale.
- o Projekti “TIMOR” do t’u ndihmoj njerëzve me aftësi të kufizuara në mënyrë që të kenë jetë më të lehtë.
- o Projekti “TIMOR” do t’u ndihmoj njerëzve me aftësi të kufizuara më ehtë të mësojnë punë të reja.

SC4: Të rritet vetëdija publike lidhur me përparësitë e procesit të deinstitucionalizimit dhe nevojën e inkluzionit të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri

- Duke i përdorur MEDIAT SOCIALE projekt “TIMOR” do tua vë në dijeni të gjithë njerëzve se personat me aftësi të kufizuara intelektuale duhet të jetojnë në shtëpi në grupe të vogla në afërsi të familjeve të tyre
 - o MEDIAT SOCIALE përbëhen nga ueb-faqet dhe APLIKACIONET të cilat ju mundësojnë të krijoni dhe shkëmbeni përbajtje.
 - Për shembull, fotografi, video-regjistre dhe informacione.
 - o APLIKACIONET janë mekanizma të cilët ju mundësojnë t’i përdorni mediat sociale në telefonin celular ose tabletë.
- Projekt “TIMOR” do tua vë në dijeni të gjithë njerëzve se të gjithë duhet të kenë mundësi të barabarta. Për shembull:
 - o gjatë arsimimit;
 - o gjatë përzgjedhjes së punës së vet;
 - o të mos jeni i neglizhuar nëse jeni me aftësi të kufizuara;
 - o të keni qasje deri te shërbimet më të mira për gjithsecilin;
 - o të mos neglizhohen personat e moshës së tretë.
- Këto rregulla u ndihmojnë të gjithëve në Evropë që të janë pjesë e shoqërisë.

GRUPET E SYNUARA

Grupe të synuara ose përfitues të fundit janë:

1. Personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre

- Aftësia e kufizuar intelektuale shpeshherë fillon para moshës madhore.
- Ajo ndikon mbi ju dhe familjen tuaj gjatë gjithë jetës.
- Anëtarët e familjeve të personave me aftësi të kufizuara shpeshherë e kanë vështirë të gjejnë kohë për t'u ofruar mbështetje personave me aftësi të kufizuara.
- Anëtarët e familjes së personave me aftësi të kufizuara duhet të punojnë dhe të fitojnë.
- Anëtarët e familjes së personave me aftësi të kufizuara duhet ta bëjnë bilancin e punës dhe jetës.
- Bilanci i punës dhe jetës nënkuption të keni kohë të kryhen punë edhe jashtë punës.
- Nëse shtëpitë e grupeve të vogla janë në afërsi të familjeve të personave me aftësi të kufizuara, atëherë ata mund të kenë më shumë kohë nga puna që t'i mbështesin anëtarët e familjes.
- Balancimi i mirë midis punës dhe jetës është pjesë e shtyllës Evropiane të të drejtave sociale.

2. Njësitë e vetëqeverisjes lokale - NJVL

- NJVL është shkurtesë e njësive të vetëqeverisjes lokale, komuna.
- Në NJVL janë vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit.
- Njerëzit në NJVL organizohen që t'u ndihmojnë personave me aftësi të kufizuara.

3. Institucionet relevante shtetërore

- Këtu bëjnë pjesë, ministritë, qendrat për punë sociale dhe organizata të tjera sociale të cilat ndihmojnë gjatë përkujdesjes së personave me aftësi të kufizuara.



4. Organizata qytetare (OJQ) të cilat punojnë në fushën sociale.

- OJQ janë grupe njerëzisht të cilët punojnë bashkë.
- Këto grupe nuk janë të lidhura me qeverinë e asnjë vendi.
- OJQ shpeshherë janë organizata joprofitabile.
- Kjo nënkupton se ato përpiken të bëjnë diçka ndryshe nga ajo Që të fitojnë para për njerëzit që i drejtojnë.



REZULTATE TË PRITSHME

Rezultate të pritshme nga projekti “TIMOR”

1. Kushte të krijuara për jetesë të mbështetur brenda bashkësisë, njohuri më të mëdha dhe kapacitete më të fuqishme të asistentëve të cilët ofrojnë shërbime për jetesë të mbështetur për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me aftësi të kufizuara janë përgatitur për deinstitucionalizim.

- Kushte të krijuara për njerëzit që kanë jetuar në institucione të rivendosen në shtëpi në grupe të vogla. Për shembull:
 - Objekte të zgjedhura të strehimit për shtëpi në grupe të vogla
 - Kontrata të përgatitura me pronarët për shfrytëzimin e këtyre objekteve;
 - Objekte strehimi të pajisura në mënyrë që të jenë të aksesshme për personat me aftësi të kufizuara.
- Persona të edukuar që t'u ofrojnë ndihmë personave me aftësi të kufizuara në mënyrë që të jetojnë të pavarur në bashkësi.
 - Kjo do të thotë të jeni të sigurt se njerëzit që do t'i ndihmojnë personat me aftësi të kufizuara dinë se si ta bëjnë një gjë të Këtillë,
 - Ata duhet të dinë se si t'u ofrojnë ndihmë personale personave me aftësi të kufizuara,
 - Ndihmë personale është kur do të pranoni mbështetje dhe kjo është bërë vetëm për ju.



2. Persona të shpërngulur me aftësi të kufizuara nga institucionet në njësi me jetesë të mbështetur (shtëpi në grupe të vogla)

- Dokumente të përgatitura për shpërnguljen e personave me aftësi të kufizuara.
- Dokumente të dërguara deri te Qendrat për punë sociale dhe kujdestarët / familjet e personave me aftësi të kufizuara.
- Transport i siguruar dhe mbështetje profesionale për shpërnguljen e personave me aftësi të kufizuara.
- Persona të shpërngulur me aftësi të kufizuara në shtëpi në grupe të vogla.

3. Programe të veçanta inovative individuale janë zhvilluar dhe zbatuar duke siguruar terapi profesionale (hortikulturore).

- Programe të përgatitura për edukimin e njerëzve të cilët duhet të kujdesen për personat me aftësi të kufizuara në mënyrë sa më të mirë,
 - Secili që do të kujdeset për personat me aftësi të kufizuara do të mund t'i përdorë këto programe.
- Plan i përgatitur për mbjelljen dhe kultivimin e bimëve të ndryshme në tokën e cila është në pronësi të Institutit Special Demir Kapi.
- Program i përgatitur për edukimin e njerëzve të cilët duhet të kujdesen për kopshtin, si ti mësojnë personat me aftësi të kufizuara që edhe ata të kujdesen për kopshtin,
- Puna në kopsht mund të ndihmoj të ndihemi mirë dhe të jemi të dobishëm kur do të shohim se si bimët lulëzojnë dhe japin Fryte,
- Kjo mund të na e bëjë jetën më të mirë dhe më të lehtë.

4. Vetëdije e rritur publike për përparësitë e procesit të deinstitucionalizimit dhe përfshirja aktive e personave me aftësi të kufizuara në bashkësi

- Njerëzit me të cilët jetojmë nuk do t'u bëjnë segregacion personave me aftësi të kufizuara
 - Segregacioni nënkuption kur dikush është i veçuar nga të tjera për shkaqe të padrejta,
 - Për shembull, për shkak të aftësisë së kufizuar të tyre.
- Njerëzit me të cilët jetojmë do të janë të solidarizuar dhe do të jetojnë në bashkësi me personat me aftësi të kufizuara
 - Solidariteti nënkuption t'u ndihmohet njerëzve të tjera,
 - Veçanërisht njerëzve të cilët nuk i njihni.
- Njerëzit me të cilët jetojmë do ta dinë se për personat me aftësi të kufizuarajtë e pavarur do të thotë se jetojnë në bashkësi dhe kanë mbështetje ta bëjnë atë që e dëshirojnë.
- Njerëzit me të cilët jetojmë do ta dinë se personat me aftësi të kufizuara në mënyrë të pavarur mund t'i bëjnë këto punë:
 - Ta bëjnë përzgjedhjen për jetën e tyre,
 - Të lidhin martesë, të krijojnë familje dhe rrisin fëmijë,
 - Të nënshkruanjë marrëveshje/kontrata (mes tjerash edhe, kontrata pune),
 - Të posedojnë llogari bankare,
 - T'i kontrollojnë paratë dhe pronën e tyre,
 - Të marrin vendime për shëndetin e tyre,
 - Të marrin pjesë në politikë dhe ta kenë të drejtën e votës.

APLIKUESI KRYESOR



CeProSARD është organizatë qytetare e themeluar në vitin 2008 me fokus kryesor të veprimit në mbrojtjen e mjedisit jetësor, aspektet sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Ekipi ynë i profesionistëve nga fusha e mjedisit jetësor dhe fushave sociale, bujqësisë, shkencave teknike dhe ekonomisë e posedon njohurinë dhe përvojën e nevojshme për realizimin e detyrave më komplekse në këto fusha. Në dymbëdhjetë vitet e kaluara punuam me intensitet në zhvillimin dhe implementimin e projekteve në nivel lokal, nacional dhe ndërkombëtar në një bashkëpunim të ngushtë me faktorët kryesorë nga vendi dhe jashtë vendit.



BASHKË-APLIKUESIT

1. Instituti Special (IS) Demir Kapi u themelua në vitin 1956, me qëllim të ofrimit të mbrojtjes dhe mbështetjes sociale për personat me aftësi të kufizuara. E mbështet procesin e deinstitucionalizimit dhe shpërçguljes së përfituesve në shtëpi me grupe të vogla. Instituti Special do të kontribuoj në realizimin e aktiviteteve të propozuara të projektit përmes përfshirjes së personelit në trajnime dhe edukimin e asistentëve për jetesë të mbështetur të personave me aftësi të kufizuara. Për nevojat e projektit, Instituti do të marr pjesë me tokë të vet të aksesshme për sigurimin e terapisë profesionale (hortikulturore). Pas përfundimit të aktiviteteve të projektit, Instituti dhe personeli i tij do të vazhdojnë të sigurojnë kujdes për personat me aftësi të kufizuara në shtëpitë me grupe të vogla.

2. Komuna e Demir Kapisë, siguron mbrojtje sociale në përputhje me Ligjin për mbrojtje sociale (neni 11). Komuna e Demir Kapisë si vetëqeverisje lokale miraton program për mbrojtje sociale në nivel vjetor. Programi parashikon bashkëpunim me Qendrën kompetente për Punë Sociale, përkatësisht Ministrinë për Punë dhe Politikë Sociale, Ministrinë e Shëndetësisë, bashkëpunim me sektorin privat dhe organizatat joqeveritare.

Qëllimi kryesor i këtij programi është zhvillimi i sistemit të integruar, transparent dhe efikas për mbrojtje sociale që do të siguroj masa të pranueshme, efikase dhe cilësore dhe shërbime të përshtatura me nevojat e përfituesve të cilët jetojnë në Komunën e Demir Kapisë.

3. Shoqata e edukatorëve dhe rehabilituesve special të Republikës së Maqedonisë së Veriut (ASERNM) është asociacion joqeveritar, profesional dhe humanitar i qytetarëve në të cilin në mënyrë vullnetare janë asociuar edukatorë dhe logopedë special, edukatorë (social) special dhe profile të tjera profesionale të cilët punojnë me persona me aftësi të kufizuara, si dhe me prindërit ose kujdestarët e tyre. Qëllimet e Shoqatës konsistonë me zhvillimin dhe avancimin e teorisë dhe praktikës së arsimit të specializuar, përmirësimin e statusit dhe cilësisë së punës së defektologjisë, promovimin dhe mbrojtjen e interesave të profesionit, si dhe promovimin, mbrojtjen, edukimin dhe rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuara.

4. Fondacioni Loza me seli në Suedi, punon për njerëzit vulnerabil në Evropë. Falë kontributit të personave fizikë, dhe korporatave të mëdha, projektet iimplementon me popullatën lokale. Në vitin 2018, Fondacioni Lozadhuroi materiale në seksionin e rehabilitimit të akomodimit në IS Demir Kapi, që përbëhet nga katër apartamente të cilat do të përdoren në procesin e deinstitucionalizimit. Bëhet fjalë për një projekt të implementuar në bashkëpunim me ASERMV dhe IS Demir Kapi, ndërsa i financuar nga UNDP Maqedoni. Fondacioni Loza si partnere e konzorciumit do të kontribuoj në realizimin e nevojave të projektit me 10% nga shuma e përgjithshme e buxhetit për deinstitucionalizim.



Kohëzgjatja e projektit:
02 Janar 2020 - 01 Janar 2023,
Projekti implementohet 36 muaj

Tekstin e përpiloj: Dragana Sofronieska

CIP – Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

364-786-056.26/.3(497.7)"2020/23"(083.94)

СОФРОНИЕВСКА, Драгана

Timor projekti: bashkë për më shumë mundësi dhe mbështetje / [Драгана Софрониевска]. - Shkup : Qendra për promovim të praktikave të qendrueshme bujqësore
dhe zhvillim rural, 2020. - 16 стр. ; 25 см

ISBN 978-608-4687-16-0

а) Лица со попреченост - Социјална инклузија - Македонија - 2020-2023 - Проекти
COBISS.MK-ID 51463941

Dizajni dhe përgatitja grafike: Konstantin Dimitrovski
Shtypshkronja: DIGITAL CENTAR



